Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Prot 06/2980/20
Data 24.12.2020
Nr. pages 02
PRISHTINË

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 21, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe nenit 7, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.12.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. *AKK–DPKI-06-1711/20*, për zyrtarin e lartë z. Binak Beqaj, Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare për Akreditim, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Binak Beqaj, Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare për Akreditim, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji par Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas denoncimit nga jashtë, e ka hapur rastin për konfliktit të mundshëm të interesit me pretendimin se z. Beqaj, si Anëtar i Këshillit Shtetërorë të Cilësisë, njëkohësisht është edhe anëtar i një subjekti politik, gjë që është në kundërshtim me kriteret për përzgjedhjen e anëtareve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/1945/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Beqaj, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Beqaj, i njëjti ka kontaktuar Agjencinë për tu njoftuar lidhur me shkresën e pranuar, ku të njëjtit i kemi caktuar një takim në Agjenci.

Në takimin e mbajtur z. Beqaj ka deklaruar se ka qenë anëtar i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dhe se para disa viteve ka dhënë dorëheqje nga të gjitha funksionet në këtë parti dhe se gjatë kësaj periudhe nuk ka ushtruar asnjë post politik në asnjë nivel të kësaj partie apo të ndonjë partie tjetër politike. Gjithashtu, z. Beqaj të njëjtën gjë e ka konfirmuar edhe në formë të shkruar përmes shkresës zyrtare DPKI-06-2329/20, të datës 21.10.2020 dhe DPKI-06-1945-1/20 e datës 12.11.2020.

Lidhur me këtë, Agjencia ka kërkuar informata edhe nga subjekti politik në fjalë, meqë rast përmes shkresës DPKI-06-2479/20, jemi njoftuar se z. Beqaj nuk është pjesë e strukturave të këtij subjekti as në nivelin qendrorë e as në atë lokal. Gjithashtu, edhe në formularët e azhurnimeve vjetore të subjektit politik në fjalë, të cilët Agjencia përmes shkresës DPKI-06-2/2592/20, i ka pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, z. Beqaj nuk figuron në ndonjë pozitë brenda këtij subjekti politik.

Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 06/2018 për Kriteret dhe Procedurat e Emërimit të Anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në nenin 4 te Papajtueshmëria për të qenë anëtar i Këshillit Shtetërorë të Cilësisë, është përcaktuar se Anëtar i Këshillit Shtetërorë të Cilësisë nuk mund të jetë personi që:

"Ka ushtruar një post politik në dy vitet e fundit" [..].

Agjencia kundër Korrupsionit, bazuar në shkresat e lëndës konstaton se z. Beqaj nuk ushtron post politik në ndonjë parti politike.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit